

VENDIM
Nr.611, datë 11.9.2003

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE "LUARASI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Luarasi", sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin nr.156, datë 22.3.2001 të Këshillit të Ministrave "Për shkollat e larta, jopublike në Republikën e Shqipërisë".
 2. Shkolla e lartë, jopublike "Luarasi" të jetë e nivelit universitar, me degën e vetme drejtësi.
 3. Kjo shkollë do ta zhvillojë veprimtarinë në mjediset e veta me adresë: rruga "Avdi Kazani" nr.1, Tiranë.
 4. Kohëzgjatja e kursit të studimit të jetë 4 vjet.
 5. Titulli i diplomës, që jepet në përfundim të studimeve të plota universitare, është "Jurist".
 6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të njohjes së kursit të studimit dhe për zbatimin e ligjshmërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano